



## “Të rinjtë nga mjediset rurale për integrim të Maqedonisë në BE”

### Donator:

Bashkimi Evropian (EuropeAid/138660/ID/ACT/MK)

### Partnerë në projektin:



### Informacione për kontakt

**CNVP – Dega në Republikën e Maqedonisë,**  
rr. Mirka Ginova, Nr. 13, 1000 Shkup;  
Tel: 02 3217 322; email:  
saso.petrovski@cnvp-eu.org

**Rrjet për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë,**  
rr. “Kosta Velinov” Nr. 3a.  
1000 Shkup; Tel: 02 3075 506;  
email: info@ruralnet.mk  
www.ruralnet.mk  
FB: www.facebook.com/  
RuralDevelopmentNetwork

**Donator:**

Bashkimi Evropian (EuropeAid/138660/ID/ACT/MK)

**Vlera e projektit:**

163.786 €

**Periudha e zbatimit:**

19.12.2017 – 18.06.2019

**Grupe synuese dhe përdorues:**

- Nxënës të mjediseve rurale nga Maqedonia Lindore dhe Juglindore
- OJQ nga Maqedonia Lindore e Juglindore
- Të rinj, banorë të mjediseve rurale nga Maqedonia Lindore dhe Juglindore
- Institucione lokale dhe kombëtare që do të kenë dobi nga rezultatet e arritura nga projekti

**Partnerë në projektin:**

Fondacioni për Lindjen e Vlerave Natyrore dhe Njerëz (CNVP)



RURAL DEVELOPMENT NETWORK OF THE REPUBLIC OF MACEDONIA

Rrjeti për Zhvillim Rural i Maqedonisë



Rrjeti për Zhvillim Rural i Kroacisë



NETWORK FOR RURAL DEVELOPMENT OF THE REPUBLIC OF SERBIA

Rrjeti për Zhvillim Rural i Serbisë

Projekti është dizajnuar për të nxitur të rinjtë nga mjediset rurale dhe organizatat qytetare nga Rajoni i Planifikimit Lindor dhe Juglindor të kontribuojnë për proceset demokratike të sundimit, përfshirë edhe gjithë palët e interesuar si dhe nxitjen e pjesëmarrjes qytetare dhe përshtatje ndaj sfidave për integrim në BE.

Raporti për të Rinjtë i Be-së në vitin 2015 ka theksuar rëndësinë e pjesëmarrjes së të rinjve në procesin e aderimit në BE dhe proceset zhvillimore në vend. Gjithashtu, BE-ja inkurajon vendet të krijojnë mundësi të barabarta për arsimin e të rinjve dhe në tregun e punës, të promovojnë aktivizmin qytetar, përfshirjen sociale dhe solidaritetin mes të rinjve.

**Qëllime të projektit:**

1. Përmirësimi i kapaciteteve të organizatave rinore dhe të rinjve nga mjediset rurale për krijimin dhe zbatimin e politikave publike me anë të dialogut me bartësit e vendimeve;
2. Përforcimi i kapaciteteve të të rinjve nga mjediset rurale për konkurrencë më të mirë në tregun e punës.

**Rezultate të pritura:**

1. Njohuri të zmadhuar të të rinjve nga mjediset rurale për çështjet lidhur me integrimin në BE;
2. Ngritje të vetëdijes së të rinjve nga mjediset rurale për rritjen e mundësive për zhvillimin e karrierës;
3. Përforcim të kapaciteteve të përfaqësuesve të organizatave rinore për aktivizëm rinor;
4. Krijimi i "Platformës Rajonale Rinore";
5. Krijimi i mundësive për dialog efikas për politikatat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe integrim në BE me ndërmjetësim të Platformës Rajonale Rinore;




## Aktivitetet të parashikuara në projektin

### **Pako pune 1:**

#### Ngritja e kapaciteteve të të rinjve nga mjediset rurale

- Mapimi i organizatave rinore dhe nxënësve që janë aktiv në politikat rinore dhe njohja e tyre me çështjet lidhur me integrimin në BE.
- Organizimi i programit për trajnim të trajnerëve për të rinjtë e mjedisve rurale për çështje lidhur me integrimin në BE.
- Organizim i punëtorive me të cilat trajnerët e trajnuar do të zgjerojnë njohurinë e përfituar mes të rinjve nga mjediset rurale.



### **Pako pune 2:**

#### Ngritja e vetëdijes së të rinjve nga mjediset rurale

- Organizimi i forumeve për këshillim të nxënësve për zhvillimin e karrierës.
- Organizim i punëtorive rajonale për të rinjtë nga mjediset rurale për mundësitë e pjesëmarrjes në programet arsimore të BE-së.

### **Pako pune 4:**

#### Themelimi i Platformës Rajonale Rinore

- Krijimi i "Platformës Rajonale Rinore".
- Takime të të rinjve dhe bartësve lokal të vendimeve për promovim të platformës rurale rinore.

### **Pako pune 3:**

#### Nxitja e aktivizmit rinor tek të rinjtë nga mjediset rurale

- Zbatimi i fushatës informative – organizimi i ngjarjeve në 5 nën-rajonet për temën e aktivizmit rinor.
- Përgatitje dhe zhvillim të ueb faqes për informim të vazhdueshëm për aktivitetet e projektit.
- Përgatitje dhe shpërndarje të buletineve elektronike.

### **Pako pune 5:**

#### Përmirësimi i dialogut

- Zbatimi i aktiviteteve në nivelin lokal nga ana e të rinjve nga mjediset rurale dhe organizatave të tyre qytetare.
- Zhvillimi i një gare për mediet lokale në temën e shembujve pozitiv të aktivizmit rinor.
- Organizim i Tryezës Kombëtare të Rrumbullakët në temën "Zëri i Rinisë Rurale në Maqedoni".

## Me anë të projektit të BE-së do të punohet në mbajtjen të rinjve në mjediset rurale!

Ngritja e kapaciteteve të të rinjve me qëllim që të bëhen faktor në krijimin e politikave lokale për zhvillim është qëllimi i projektit "Të rinjtë nga mjediset rurale për integrim të Maqedonisë në BE".

Projekti ishte promovuar më 27.02.2018 në Shkup dhe është financuar me mjetet e BE-së, dhe e zbatojnë katër organizata. Udhëheqësi i projektit është Dega në Maqedoni e Organizatës për Lidhje të Vlerave Natyrore dhe Njerëz (CNVP) me seli në Hagë, Holandë, ndërsa partnerë në zbatimin e projektit janë Rrjeti për Zhvillim Rural i Maqedonisë, Rrjeti për Zhvillim Rural i Kroacisë dhe Rrjeti për Zhvillim Rural i Serbisë.

Në ngjarjen promovuese ishte theksuar që projekti do të fokusohet në të rinjtë nga Rajoni i Planifikimit Lindor dhe Juglindor në Maqedoni ku organizatat zbatuese të projektit do të mundohen të animojnë të rinjtë dhe organizatat rinor që punojnë me të rinjtë që përforcojnë kapacitetet e tyre për aktivizëm rinor, zhvillim të karrierës dhe të aftësojnë për të ndikuar mbi sjelljen e politikave në nivelin lokal.

Migracioni i përditshëm i të rinjve nga fshati në qendrat urbane, madje edhe nga shteti është një problem serioz. Me anë të këtij projekti, do të adresohen nevojat e këtyre të rinjve në nivel më të lartë, dhe do të mbështeten për të afruar në burimet e ideve dhe iniciativave, si dhe në mjete financiare për të realizuar nevojat e tyre. Projekti do të zgjat 18 muaj, gjegjësisht deri në qershor 2019.



# Mapimi i të rinjve aktiv rural dhe OJQ në Rajonin Lindor dhe Juglindor

## Metodologji dhe mostër

### Zbulime kryesore:

- 310 përgjigje janë mbledhur me anë të hulumtimit në teren duke përdorur një pyetësor të strukturuar
- 16 intervista me aksione të organizatave qytetare nga rajoni lindor dhe juglindor në Republikën e Maqedonisë, duke përdorur pyetësor gjysmë të strukturuar


Ekipi i hulumtimit ka pasur sukses të arrijë numrin e synuar të të anketuesve në periudhë prej dy javëve, me çfarë ka parandaluar që ngjarjet e mëdha politike të ndikojnë mbi përgjigjet.

Për këtë hulumtim, ekipi ka përdorur një qasje të kombinuar metodologjike, që konsiderohet si i përshtatshëm për anketimin e dy grupet kryesore të synimit - qasja sasiore për nxënësit e shkollave të mesme dhe qasja cilësore nga OJQ-ve në rajonin. Për nxënësit e shkollave të mesme të përfshirë në këtë hulumtim ishte krijuar një pyetësor i strukturuar ndërsa për mbledhjen e të dhënave nga përfaqësues të OJQ-ve ishte dizajnuar një pyetësor përkatës gjysmë i strukturuar. Pyetësori ishte dizajnuar në mënyrë që do të jep një vizion të qartë në disa kategori: (1) struktura demografike e mostrës, (2) (pa) kënaqësia nga jeta e përditshme dhe mundësitë e dhënë në jetën e përditshme, (3) shqyrtimet ndaj Bashkimit Evropian dhe njohurisë së përgjithshme në fushën, dhe (4) angazhimi qytetar dhe fushat prioritare që kanë përmirësim më të madh.

Ky projekt është drejtuar ndaj rajonit lindor dhe juglindor të Republikës së Maqedonisë, gjegjësisht rajonet rurale në këtë rajon të vendit. Grupi fillestar i synuar prej 300 të anketuar, të parashikuar me projektin kanë qenë një mostër mjaft përfaqësuese nga rajoni, andaj ky zbulim mund të

konsiderohet si përfaqësues me margjinë gabimi +5%. Përveç përfaqësimit të mostër, hulumtimi ka përfshirë edhe të dhëna nga fusha e gjerë gjeografike të dy rajoneve, përfshirë edhe të anketuarit nga komunat më të mëdha dhe më të vogla.

Anketa me pyetësor ishte zbatuar nga hulumtuesi në teren i angazhuar nga projekti, në shkolla të mesme paraprakisht të zgjedhura dhe me nxënësit e vitit të tretë dhe të katër të arsimit të mesëm. Zgjedhja e shkollave ishte bërë duke marrë parasysh numrin e nxënësve të regjistruar nga komunat e vogla rurale. Komunat e zgjedhura ishin: Shtip, Koçanë Vinicë, Dellçevë, Strumicë, Gjevgjeli, Radovish (si një prej komunave më të mëdha me shkolla të mesme). Numri i pjesëmarrësve në hulumtim në shkollat e ndryshme të mesme ishte përcaktuar në mënyrë proporcionale me numrin e nxënësve të regjistruar në shkollat.



## Rekomandime

Roli kryesor i kësaj analize ishte të prezantohen vështirësitë me të cilat nxënësit e shkollave të mesme dhe organizatat qytetare të mjediseve rurale përballohen dhe në atë mënyrë kanë inspiruar të ofrojmë zgjidhje potenciale.

E para, për të përmirësuar mobilitetin, që është një prej problemeve më të mëdha siç ishte prezantuar më lartë, me rëndësi është infrastruktura dhe transporti publik të avancohen sipas nevojave të shekullit XXI. Kjo do të thotë që të rinjve nga këto rajone duhet të mundësohet që vështrojnë mobilitetin si një pjesë normale të jetës së tyre, si nevojë themelore, dhe jo një luksoz.

Përveç kësaj, modernizimi i bujqësisë mund të hap shumë vende të reja pune që janë të nevojshme. Niveli i papunësisë së të rinjve në këto rajone gjithashtu mund të zvogëlohet me ofertë të punëtorive për aftësi të buta, që sistemi arsimor për momentin nuk mund të sigurojë. Kjo drejt-përdrejtë ndërlihet me nevojën e shumëfishtë të vërejtur për krijimin e më tepër mundësive për të rinjtë nga mjediset rurale dhe për rajonet rurale që të jenë më tërheqëse për personat e rinj.

Përveç kësaj, orientimi drejt nevojës për njohuri mbi temat e vlerave, mundësive dhe rëndësisë së BE-së, nuk sigurohen vetëm njohuri teorike por edhe praktike, dhe me siguri është një element kryesor që më tutje mund të integrojnë si nxënësit ashtu edhe OJQ-të në familjen e madhe evropiane.

Si konkluzion, në lidhje me mendimin e të anketuarve nga hulumtimi, vështirësitë kryesore të rajonit, përveç zhvillimit të infrastrukturës, janë, pjesëmarrja e të rinjve në proceset e krijimit të politikave dhe vendimeve, informacione më të mira për proceset e integritimit në BE dhe mbi BE-në në përgjithësi, si dhe punësimi i të rinjve nga rajoni që shkakton një nivel të lartë të ikjes së personave (brain drain).

Në bazë të rezultateve, ekipi i hulumtimit propozon zhvillim dhe zbatim të punëtorive vijuese për të rinjtë nga rajoni:

- Aktivizëm rinor
- Metoda për pjesëmarrje në procese të politikave dhe marrje të vendimeve
- Udhëheqësi dhe shkathtësi tjera të buta dhe shkathtësi për punësim
- BE, institucionet e BE-së dhe integrimi i Maqedonisë në BE

## Trajnim për trajnerë


Trajnimi për trajnerë ishte një ngjarje kryesore dhe konsiderohet si një pikë kthimi për zbatimin e projektit. Në ngjarjen që u zhvillua nga 25 deri më 27 qershor në hotelin Gligorov në Strumicë, për të cilën më para ishte bërë një punë e madhe e përzgjedhjes së pjesëmarrësve, për të cilën si bazë ishin marrë rezultatet nga mapimi që ishte bërë paraprakisht. Procesi i zgjedhjes ka përfshirë një vizitë të gjithë kandidatëve nga ana e udhëheqësit të projektit dhe ndihmësit të tij, ndërsa rezultat ishte 15 persona të rinj të zgjedhur në mënyrë të kujdesshme nga rajonet e synimit që kanë shprehur interes mbi temën, por edhe për bashkëpunim të mëtutjeshëm në sajë të projektit si dhe për rrjetëzim të ndërsjellë.

Partnerët e projektit nga Kroacia dhe Serbia kanë siguruar trajnues me përvojë, z. Zhelko Plavsic dhe Igor Stajic nga qendra rajonale për arsim në Leskovac, si dhe z-nja Mirela Trava nga Rrjeti Rinor i Kroacisë.

Në trajnimin prej tre ditëve pjesëmarrësve të rinj ju ishin prezantuar parimet e përgjithshme të formimit dhe veprimit të Bashkimit Evropian, me anë të:

- Prezantimit të politikave të BE-së në fushën e integritimit, përfaqësimit të interesave dhe politikat rinore
- Prezantim i instrumenteve institucionale që janë në dispozicion në vendet që janë në fazën e aderimit në BE
- Trajnim për pjesëmarrësit dhe përfitim i njohurive për kopjim në të ardhmen
- Trajnim për pjesëmarrësit dhe përfitim i njohurive për shkathtësi për përfaqësim të interesave
- Përmirësim i shkathtësive në lidhje me udhëheqjen dhe aftësive për prezantim





Pjesëmarrësve ju ishin prezantuar shumë video materiale nga vendet fqinje dhe bota me shembuj të përfaqësimit dhe ndikimit të shoqërisë qytetare në politikat lokale dhe globale që i përfshijnë njerëzit.

Gjatë trajnimit, nga pesëmbëdhjetë pjesëmarrësit, ishin përcaktuar 5 grupe me ndarje gjeografike dhe ishin akorduar trajnimet e para për shpërndarje të njohurive të përfituara. Për përgatitje dhe zhvillimin e tyre, trajnerët e rinj do të fitojnë ndihmë praktike nga shumë aspekte me anë të mentorit të angazhuar për këtë qëllim që punën do të fillojë në fillim të muajit korrik.

Pjesëmarrësit ishin të njoftuar edhe me:

- *Politikat themelore të BE-së*: politika sektoriale, qëllime dhe rezultate të arritura (Misioni i BE-së, si funksionon BE-ja, çfarë bënë BE-ja, çfarë do të thotë të jesh qytetar i BE-së, Evropa – vendi i lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, data kryesore në historinë e BE-së)
- *Bazat e procesit të aderimit* (përfshirje, mundësi të barabarta për të rinjtë, politika të punësimit):
  - Kapitulli 19: Politika sociale dhe punësim
  - Kapitulli 11: Bujqësi dhe zhvillim rural
  - Kapitulli 25: Shkencë dhe hulumtim
  - Kapitulli 26: Arsim dhe kulturë
- *Përfshirja sociale në BE dhe vendet kandidate* (Platforma Evropiane kundër Varfërisë dhe Përfshirjes Sociale, Korniza Evropiane për Kohezion Social dhe Territorial)
- *Përfaqësim në procesin e aderimit* (shembuj dhe ushtrime)
- *Përfaqësim dhe ndryshime pas hyrjes në BE*



Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian

---

Ky botim është përpiluar me ndihmën e Bashkimit Evropian.  
Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Fondacionit CNVP dhe nuk mund të merret në asnjë mënyrë për të pasqyruar mendimet e Bashkimit Evropian.